



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 26-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 28.02.2020 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 19. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Riza Dreshaj, LDK; | 22. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 25. Radoš Repanović, SLë |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 14. Misin Berisha, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z.Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 26-të të rregullt, të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2019.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit tre vjeçar i aktiviteteve të Grupit të Grave Asamblistë për periudhën 2020-2022.
5. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksë Ngarkesa dhe Gjoha,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2019.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimeve (01Nr.44/2020 dhe 01 Nr. 45/2020) të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim me negocim,
8. Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020 .
9. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – pyet anëtarët e Kuvendit nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës, pasi që askush nuk u lajmëruar, hedh në miratim rendit të ditës:

Kuvendi unanim miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se të gjithë anëtarët e Kuvendit janë prezentë në mbledhje dhe nuk mungon askush.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal? Labinot Aliaj ka kërkuar fjalën.

Labinot Aliaj – përshëndetje për të gjithë në fjalimin tim për bursa unë kamë thënë 38 e jo 88 siç me është shkruar ne procesverbal kjo të rregullohet.

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: të gjithë anëtarët e KK.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2019, fjalën ja kaloj z. Enver Rugova,

Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – prezanton dhe sqaron Raportin vjetor të NP. "Ambienti" për vitin 2019,

Naim Blelulaj - përshëndetë të gjithë të pranishmit, në bazë të raportit e përmendem zgjerimin e rrjetit, kështu që kërkoj të hy në këtë zgjerim të rrjetit edhe fshatrat e mivadës kërkoj që deri në qershor të jetë muaji i fundit dhe ju të përgatiteni që këto fshatra të hynë në zgjerim të rrjetit.

Enver Rugova - zgjerimi do të bëhet së pari ka qenë kjo rruga Januzaj Prigodë-Lubovë për mbeturina ka qenë prioritet se u krijoishin deponi ilegale që i kemi hjek rend disa here për disa vite e tashti ma pak po behën d.m.th aks pasur sukses ajo që atë aks rrugor i kemi përfshi ato komunitetet por edhe fshatin Shushicë e ulët edhe një pjesë e Shushicës i kemi përfshi çështja është të mungesa e kamionëve se për kompaninë edhe për komunën nuk do të ishte problem qeveria japoneze e ka nda një fond që se bashku me kryetarit dhe drejtorin e bordit që me ble një kamionë, presim në atë kohë që thatë dhe menjëherë do të fillojmë operimin në atë zonë.

Jehonë Haxhijaj - përshëndetë të gjithë të pranishmit, pothuajse pyetjen e njëjte e kamë me Naimin kur kompania Ambienti do të filloj shtrirjen e fshatit Rakosh, Uçë dhe fshatrave përreth që gjenden pasi që e cek që kjo kompani është rritë është zgjerua si në aspektin kualitativ dhe financiar pasi që është rritur edhe financiarisht besoj që ka kapacitet të shtrihet edhe në ato pjesë e mbajë mend kur herën e kaluar ka raportuar drejtori e ka cekë që qeveria Japoneze do të na ndihmoj me kamionë, po kërkoj përgjigje kurë.

Enver Rugova - e dhashë edhe një here atë po edhe për informimin e juaj tri herë kompania "Ambienti" ka hapur tender për blerjen e tre kamionëve dy për nevoja të komunave të tjera Pejë, Klinë dhe një për Komunën e Istogut, kanë dështuar ofertat për shkak të kualitetit edhe qëndrueshmërisë së atyre kamionëve që janë prezantuar në tender, tash e kam informatën sot prej drejtorit të regjionit të Pejës që e kanë bërë hapjen edhe një here edhe besoj që kësaj here do të ketë suksese.

Labinot Alijaj - përshëndetë të gjithë – kisha dashur ta përshëndes menaxherin z. Sadik Bujupi për punën që e bënë se është një raport shumë i mirë i detajuar dhe mënoj që ish dashur me ja jap një shpërblim si menaxheri me i mirë i vitit e kamë një pyetje për drejtorin për këtë pjesë të terrenit ku jeni të shtrirë sa raste janë sociale dhe sa janë të liruar nga kjo pagesë si është puna e tyre.

Enver Rugova – janë dikund 250 që janë të liruar nga pagesa, është një marrëveshje e në nivel regional e njëjta që të gjithë ata që nuk mund të paguajnë për me pas keqkuptime me marrëveshje kompania me përfaqësuesit t fshatit bëjnë marrëveshje që disa kategori sociale që nuk kanë mundësi me pagua me u liruar.

Mirushe Sadikaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, e përshëndes drejtorin e kompanis Ambienti për inkasimin e lartë po inkasim po shifet që është baraz por pasi e shpjegoj drejtori atëherë po e dimi që për shkak të borxheve të mëparshme inkasomi është me i lartë se sa faturimi prandaj edhe vitë e kaluar ka qenë inkasomi i lartë mirë po shihet se kapacitetet operative nuk merrini por po shihete se makinat janë të vjetra, në raport po thuhet se një kamionë në vitin 2015 është blerë por aj nuk ka punuar vetëm tre muaj dhe është defekt edhe pasi që kemi pasur të hyra është dashur me qenë kamioni i tipit me të ri ose që ka mundësi me punu edhe një pyetje kamë sa i përket projektit të GIZ thuhet se projekti nuk është realizuar GIZ-i 1 dhe ka filluar projekti GIZI 2 nga ky projekt kemi fituar disa kontejner edhe të tjera d.m.th pse ka filluar projekti i GIZ-it 2 pa përfunduar GIZ-i 1.

Enver Rugova – në vitin 2018 GIZ-i e ka nda një grand si në komunat tjera po ashtu edhe komuna jonë krejt Kosovë nuk i kanë marr këto grande ose nuk kanë fitu nga ajo se çka është fitu edhe nga GIZ-i edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës tu e përfshi Ministrin e zhvillimit Ekonomik edhe Agjensionin për menaxhimin e mbeturinave jemi interesuar edhe si agjencion i komunave të Kosovës së Kolegjiumi i drejtorëve të shërbimeve Publike edhe GIZ-i edhe në nivel qeverie ish zëvendës ministri i Zhvillimit ekonomik edhe ka mbetur pa përgjigj para neve edhe unë tani skam përgjigje tani ju me ju dhanë, aty është krijuar një vakum nuk kamë përgjigje me ju dhen është një vakum aty është krijuar rreth atij fondi dikund rrethë tre milion e gjysmë që GIZ-i ka qenë i detyruar që me ato fonde të gjitha procedurat prokurimit me i kry në shtetin e tyre në Gjermani dhe me i sjell mjetet e reje në Kosovë në Bazë të komunave si i kanë përfiturar kjo nuk është bërë kjo GIZ-i 2 është tjetër dhe nuk duhet ta lidhim me atë të parin së GIZ-i 1 është një shpërblim GIZ-i 2 është një formë operative në teren që p.sh në qytetin e Istogut e kanë bërë një riformatim të pikave mbledhës të mbeturinave sepse në çdo qytet është problem vendosja e kontejnerëve, kështu që 16 pika në qytetin e Istogut i kanë shuar po ashtu ka edhe disa dilema të zhvendosjes së Kontenjerve dhe qytetaret dej e kanë kuptuar atë pak ka pasur telashe po këtë me rekomandim të ekspertëve edhe ndërkombëtar edhe të Kosovës që punojnë në GIZ ne na duhet me ju përshtat atij reformimi , kështu që kjo metodologjia e GIZ-i 2.

Slavisha Malinkovic – Kam një pyetje per drejtorin, kur eshte ne plan përfundimi i kanalizimit ne fshatin Serbobran, dhe poashtu te jua përkujtoj se fshati Serbobran ka jep 4-5 hektare toke (utrinë) per shtëpitë e egjiptianeve, kështu qe edhe moralisht ju takon ta përfundoni kanalizimin, pasi eshte kryer per komunitetin egjiptian e per komunitetin shumice nuk eshte kryer.

Enver Rugova – sa i përket kanalizimit në Serbobran ne kemi biseduar edhe me këshilltarit edhe me përfaqësues të tjerë edhe përfaqësuesja e zyrës të komunitetit jo shumicë që është në komunën me shefin e zyrës komunale të komuniteteve, projekti është kemi aplikuar në ministrin e kthimit ose edhe në ministrin tjerë kështu që projekti detal pasi që është besoj që do ta marrim ndonjë donacion nga ministria ose nga organizatat tjera ne si komunë i kemi bërë aplikacionet dhe presim përgjigjet tjera.

Slavisha Malinkovic – unë kërkoj falje, për komunitetin egjiptian është kryer, përmes zyrës së komuniteteve përkatësisht nga Rasim Mahmutoviqi, përpos komunitetit egjiptian të tjerët nuk kanë qene ne gjendje që të lidhen në atë kanalizim.

Enver Rugova – afër rrugës ju nuk keni kanalizim pa marrë parasysh komunitetin aty, prapë po them projekti është edhe për këto tjerat.

Naim Imeraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, për punën e mirë nuk është me rendësi në cilën anë jemi të ulur të kësaj sale por duhet me dhen vlerësimin vazhdon një punë e mirë e kësaj ndërmarrje NLP “Ambienti” rezultatin e asaj pune e shohin çdo ditë ashtu siç është puna i shkoqitur në nivel është edhe raporti ajo, çka me brengos më është laburuar nga kolegët çështja e GIZ-it e çështjeve tjera unë vazhdoj ta kem problemin apo mos pajtimin me faktin që ndërmarrja nuk po i dihen performancat financiare dhe lokale tjera në vjet i kemi qe 60 e diçka mijë e sivjet 100 mijë e po na vin kamionë të cilët nuk mund të përdorim 3 muaj ose nuk na vën fare kamionit duhet ta gjejmë një modalitet nëse është fjala të bordi ekzekutues ose të shefi ekzekutues të ju bëhet pak presion që proporcionalisht që me kontributin ta kemi edhe kthimin tash a janë të politizime nuk dua të hyj anej apo kush është e kush s’është, po me intereson që a është edhe në ngarkesën maksimale sezonale të ardhurën e K. Istogut që jetojnë jashtë kompania ambienti ka mbërri me qenë në nivelin e detyrës diçka që është për tu përshëndetur kështu që është kjo ishte ajo çka deshta.

Arif Elshani – përshëndet të gjithë të pranishmit, po me intereson si është gjendja me deponi ilegale a keni evidencë sa ka apo nuk ka deponi ilegale dhe si po trajtohen edhe pse në raport po shihet se po trajtohen, por në këtë vit si po trajtohen, deponia në Toqep shifet se diçka kanë punuar me një tender por ajo me këtë punën që është bërë ajo ende një gjendje shumë të mjerueshme a planifikohet diçka më tepër në Toqep . Edhe qeto për 100 mijë euro si foli edhe Naimi që kanë tepër ato a i menaxhon Peja apo i menaxhonu ju, qoftë se ato mjete një numër i konsiderueshme mund të zgjidhen ato mekanizma me ato pare. Mendoj që ndërmarrjeve shtetërore institucioneve shtetërore nuk ju vlen me mekanizma të vjetër vetëm mekanizma të vjetër çdo herë problemet lindin dhe mendoj që më tepër duhet të jeni të përkushtuar që çështja e deponimeve ne e dimi si ka qenë viteve të kaluara ne shihemi se jemi me të përkushtim por shihen deponit ilegale ato që janë sa më shumë të eliminohen.

Enver Rugova – kjo çështja sepse unë thash edhe me parë që statuti i kompanisë e bënë të tillë që Peja , Klina dhe Istogu janë aksionar të KRM Ambienti Pejë. Ne nuk jemi hy vetëm sepse hupim shume grante dhe shume subvencione.

Arben Kabashi - përshëndet te gjithë te pranishmit, sa i përket raportit dua një sqarim a kemi të hyra ma shumë prej përmbaruesve a për shkak te shtrirjes që është ber te shtrimi. Dhe e dyta e kamë ber një krekës në emër të lokalitetit prej presionit tyre që kom pas e kom shtrua drejtoratit për shërbime publike ku kanë kërkuar që në raport është e vërtet ajo që kohë pas kohe qendrat urbane mirëmbahen fshihen pastrohen, thjeshte kanë kërkuar mos ka qen mirë që përmes kompanisë ambienti ka me i punësuar 4 vetë në qendër urbane që të jenë të përhershëm ata në mirëmbajtjen e atyre qendrave , e marr shembull Gurrakocin nuk e di a e keni parë rrugën Gurrakoci thirret prej qendrës dhe tash edhe për shkak të tregut të druve që i qesin aty janë të uzurpime trotuaret po ashtu është kriju një deponi aty mund ta shini te rrethi aty kioskat aty mund të shkoni ta shihni është një deponi kogja e madhe po thuaje e gjithë ajo pjesa aty. Kërkoj që në të ardhmen përmes kompanisë të ketë të punësuar aty të përhershëm e jo athok që është kërkesë jo vetëm e komunitetit aty por ndoshta e drejtorit të caktuar që mos mi dhanë shkas askujt me u ankua për mos pa pasterti aty sa i përket raportit është një raport i detajuar, është ngritje e kompanis.

Agron Avdiqaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, në fakt mendoj që raporti është me i dobët se sa puna që e ka ber kompania Ambienti, dua sugjerime me i dhen në këtë drejtim sepse shumica e pyetjeve u dhanë në këtë drejtim informatat ekzistojnë por nuk ekzistojnë në raport duke u nisur nga rastet sociale tu u nis nga të hyrat e përmbaruesve është mirë dhe me u cek në raport mandej madje është mirë me u ditë me pas edhe listën ku janë të shtrira, e di ku janë të shtrira më shumë pojo, e besoj që të raporti mundet më u përmirsu në këtë drejtim. E performaca po besoj që edhe te inkasomi vlera 97mijë euro përdëra sa nuk është përgjegjësi e ambientit lokal këtu besoj që ka me vazhduar me qenë vështirsi kështu në këtë drejtim nuk e di qikjo ndarja me tentu me bë kompani lokale a ka me na ndikuar pozitiv apo negativ, por kurë performanca është e mirë mendoj që edhe projektet përkundrazi së kanë fokus kur kanë rrjet kurë ka performanc të mirë një kompani lokale është edhe interes i donatoreve pikërisht mi përkrahë ndërmarrjet të cilat kanë sukses andaj nëse ky sukses është real që po pajtohemi do të besoj që është ndoshta njëri nga indikacionet që në të ardhmen mundet me u bë edhe kompani lokale publike.

Kryesuesi, Pasi që nuk ka diskutime tjera po vazhdojmë.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit tre vjeçar i aktiviteteve të Grupit të Grave Asamblistë për periudhën 2020-2022, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ja kaloi

Ajshe Metaj, kryesuese e GGA-së - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Planit tre vjeçar i aktiviteteve të Grupit të Grave Asamblistë për periudhën 2020-2022.

Agron Avdijaj - si sugjerim që në të ardhmen edhe ne si asamblistë që prezenca e drejtoreshave këtu mos në përfaqësohet vetëm nga një femër, të jeni ma insistuesë.

Ajshe Metaj - objektivë është ajo, në pjesëmarrje dhe në vendimmarrje, ne e kemi vetëm një drejtore që është shumë e suksesshme dhe të gjitha grat drejtoreja janë dhunë të suksesshme dhe kisha insistu që të kemi më shumë drejtoreja.

Kryetari i Komunës - përshëndet dhe i përgëzon grat asamblistë për iniciativën e tyre, shpesh kemi pasur edhe takimi të ndryshme edhe me ka lenë përshtypje të mira organizimi dhe bashkëpunimi juaj i sinqertë pavarësisht nga cili subjekt politik vini, Ajo për mu është tejet e rëndësishme dhe mendoj së ashtu duhet të jetë pajtona. Mos ta bëjmë formal por të përkushtohemi të gjithë nga unë në radhë të par edhe ju si kuvend këto kërkesat e juaja që i keni ti parashtroni ekzekutivit, rreth buxhetit qen kanë disa shifra nëse mundeni me na sqaruar.

Ajshe Metaj - mund t'ju sqaroj vetëm se nuk deshta të hy në specifika, pra ne në çdo tre mujor e kemi paraparë nga një aktivitet që lidhën me objektivat edhe janë shumat e specifikuar shumat e përgjithshme është 5550 euro kjo vlen për tri vjet.

Dua të ndërlidhem këtu me kryetarin që ne jemi në këtë kuvend partia e tret dhe koleget asamblistë dua ti falënderoj që pa kurrfarë dyshimi ma kanë ofruar këtë post, jo që është përgjegjësi por nga ana tjetër tek ne nuk shihet kush kujt i takon ne i kemi interesat si gra dhe kjo na dërgon tek arritja e sukseseve, i falënderoj koleget për përkrahjet.

Kryetari i Komunës - e përkrahi mendimin e Agronit që të ketë përfaqshim me të mirë të grave në poste udhëheqëse, donë pak kohë edhe pse ton kohën jam përkujdesur e din edhe stafi, në konkurse çdoherë përparësi kanë pasur prirje të jenë më shumë femra dhe do të arriemi.

Ajshe Metaj - para 2020 ne e kemi pasur planin e përgatitur pasi që ka qenë vetëm për 1 vit ne e kemi shty dhe e kemi punuar për 3 vite.

Jehonë Hagjijaj - dështa me u ndërlidh me Agronin, e kam lexuar shumë mirë planin dhe është e cekur që pozitat e synuara që të udhëhiqen nga grat nga një drejtorët që aktualisht është një të rritet në 4.

Lavdie Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, krejt çka u deshtë me u thanë veç e thanë kolegët, veç dështa të ndalem pak që ky planë 3 vjeçar është i hartuar mirë edhe presim nga kolegët këtu me na përkrah dhe ekzekutivë, nuk është se si grup i grave nuk kemi punuar në këtë periudhë kemi bërë një mori aktivitete mirë po krejt çka deshta të them që shumë takime ne si gar e shohim të mangët nga drejtorët nga ekzekutivi që vendimet kërkesat e tona të jenë me të fuqishme pres që në takimet e ardhme ekzekutivi të jetë prezent ku jemi ne.

Labinot Alijaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, vetë deshta ti përgëzoj për punë e bërë grupin e asamblistëve. Deshat kryetarit meqë drejtorin e urbanizmit e ka propozua për zëvendës ministër në vend të ti ta emëroj një drejtoresh të gjinisë femërore.

Kryesuesi, pasi që nuk kemi diskutime tjera hedhe në votim këtë pikë të rendit të ditës

Kuvendi unanim miratoi Planit tre vjeçar i aktiviteteve të Grupit të Grave Asamblistë për periudhën 2020-2022,
Në procedurën e votimit ishin 22 anëtarët e KK.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,, fjalën ia kaloi Hysni Maxharraj, drejtor për buxhet dhe Financa.

Hysni Maxharraj - përshëndet të gjithë të pranishmit - bënë prezantimin dhe sqarimin e Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Naim Imeraj - po ne vëllim i ndryshimeve të bën kureshtar me ditë ne detale, te gjeodezia dhe kadastër a kalon krejt kompetenca e atyre ngarkesave hiqet nga Rregullorja jonë dhe punohet sipas udhëzimeve të ministres apo duhet të revidohet ato shuma që janë aty edhe e dyta pjesa e fundit prej deri mu po me duket si në gjykata e vlerëson gjyqtari gjobën, po taksa nuk e di prej deri a është e përcaktuar si funksionon, pasusi i fundit.

Hysni Maxharraj - të kadasta ministria përkatëse rekomanduar këto janë çmimet edhe në rregullore edhe në udhëzime po kanë rekomanduar të mos ketë konfuzitet të punohet sipas udhëzimeve ato tri pika që i përmenda duhet të figurojnë në rregullore në nenin përkatës. Është lista përkatëse që punojnë zyrtarët të gjobat në vitin e kaluar e kemi diskutuar bashkë po këtë pikë dhe e kemi caktuar pikën me të ulet 6.1 20 euro ka qenë pre 20 deri në 50 ne jemi përçarë për 20 e kanë dërguar listën komisioni që më vendos kështu, të vendosim së bashku këtu.

Mirushe Sadikaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, ne kemi të drejt me kërkua me ndryshuar diçka. Vetëm pjesën e fundit.

Hysni Maxharri - vetëm këto që i përmenda që foli Naimi, 6.1, 6.2 dhe 6.3 të neni 12 te gjobat, tjerat s'mund ti lëvizim.

Kryetari i Komunës - nuk e di pse duhet të jenë në Rregullore ato të cilat janë të përcaktuara me ligje.

Mirushe Sadikaj - propozoj që të ulen pikat të ulen.

Hysni Maxharri - ne i kemi caktuar bashke tarifat me të uleta, por Ministria përkatës ka propozuar me i ndryshu e kemi edhe listën këtu.

Ashtu siç është propozuar e kam rregulluar tani para jush po e prezantoj siç ka rekomanduar Ministria të jetë.

Agron Avdijaj - po mendoj që ata e kanë qit qartë prej 50 deri 100 ka thënë vendosni ju sa doni të jetë gjoba, ne mund ta marrim minimalen, propozoj të shkohet me pragun minimal të trijat, se nuk mund ta lemë 50 deri 100 sepse zyrtari do të ketë problem si do të ja bën.

Hysni Maxharraj - ne i kemi vendosur shumat minimale, por rekomandimi është që të vendosen ashtu siç janë në ligj.

Naim Ineraj - mendo që mundet nëse ka hapsirë në qoftë ligjore që me një akte të brendshmen të përcaktohet në nivelin e drejtorisë nëse komuna e ka atë kompetencë.

Hysni Maxharraj - lexon listën e konfirmimit të ligjshmërisë. Dhe sipas kësaj shkrese unë i kam rregulluar në Rregullore.

Zenel Shatri - përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nuk e di s'po mund ta kuptoj shume mirë, a e kanë kthyer ata vlerën me të lutën nuk e kanë lanë, dhe a e kanë kthyer me e hjekë.

Hysni Maxharraj - kanë propozuar me vendos kështu prej deri jo me i caktu shumat.

Zenel Shatri - nuk e di ndoshta tjerët e kanë të qartë, ne e kemi pasur 20 e rash si e kanë propozuar. Le të jetë 20 edhe e dyta 50 si kanë qenë përpara.

Ajshe Metaj - ne e kemi përcaktuar gjobat minimume në Rregullore, mirë po faktikisht mendoj që e kanë kufizuar këtë afat kohorë që ndoshta ky ndryshim i këtyre vlerave të bëhet nga koha së sa është vonuar me bërjen e regjistrimit.

Lulzim Blakaj - përshëndet të gjithë të pranishmit - kështu siç është në rregullore është e përcaktuar me ligj dhe ne nuk mund ta ndryshojmë as ta caktojmë ndonjë shumë vetëm siç është e shkruar në ligj, kjo dispozita nuk bën me u ndryshu.

Arif Elshani - neve na kujtohet që kur është në pyetje regjistrimi i lindjeve le të është sa të është pore ne kemi problemin me çregjistrimin e te vdekurve e për ato 20 euro ose 50 euro s'po mundet me çregjisë, por problemi që aq shumë dokumente që lypen, unë personalisht nënën time nuk mund ta çregjistroj që 10 vite kamë ardhur disa here, ju lutem që ne si kuvend komunal ta bëjmë një Rregullore apo një akt tjetër që ata njerëz që kanë vdekur mos të lypen kaq shume dokumente, ta gjejmë një Rregullore për të mirën e popullatës ndoshta edhe janë shumë 50 euro me çregjistrimit të vdekurit. Pavarësisht nëse është urdhëresë e nivelit qendror ne nuk mund të ndryshojmë por ne si kuvend komunal ta gjejmë një Rregullore dhe njëzëit që kanë vdekur me vite të tëra ti çregjistrojmë disi.

Kryetari i Komunës - mendo që në kuadër të kësaj nga 20 deri në 50 askush ne nuk na ndalon me u përcaktuar për shumën, se aty ka mundësi me pas pakënaqësi të qytetarët pse mu 50 ati 20, nëse ka bazë ligjore po e marr një vendim dhe jua dërgoj zyrës së regjistrimit civil edhe pse faktikisht është çështje e kohës kur kjo zyre do të kalojë komplet me kompetenca me ministrin e punëve të brendshme, por deri sa është kështu të merret një vendim që mos të ketë laramani por gjobat të jenë të njëjta për të gjithë. Pajtona me Arifin jam i sigurt që ka njeri që nuk i ka çregjistron për shkak të gjobës ka boll.

Zenel Shatri - me sa e kuptova nga juristi në mënyrë ligjore ne nuk paskemi të drejt me ndërhy me caktu ne pasi që nuk kemi të drejt me caktu ne, nëse ka mundësi kompetenca e kryetarit me e caktu, këtë me mirë e din juristet se ne. Ata nuk mund ta prekin a ka mundësi që brenda me be na këtë përcaktim.

Agron Avdijaj - pavarësisht shpjegimit siç e bëri drejtori Luli mëndoj që ai përshkrim nënkupton që ne si kuvend duhet me vendos a 20 a 50 ta ka lanë hapësirën si kuvend me vendos ta ka dhen kufizimin mes 20 dhe 50, me pas kanë ashtu i kish caktu si të tjerat, po mëndoj që ka len ne me vendos jam për meshkuj më minimalet.

Labinot Alijaj - edhe unë jam i pajtimit me këtë që po e thotë Agroni ne si përshkrim s'mund me lënë nga 20 deri ne 50 mirëpo të shuma për secilën shumën mund ta caktojmë në minimumin ose maksimumin.

Arif Elshani - pyetje a votohet kjo rregullore nëse votojmë ne e votojmë me 20 ata le të bëjnë te vëten.

Naim Behlulaj - ne në bazë të kësaj Rregullorja po na len lluftë diferenca është mirë me marr një vendim me len minimumin, p.sh shkoj unë me bë një çregjistrim mi merr 20 euro ndërsa tjetrit 50 kjo nuk është në rregull.

Kryetari i Komunës - ligji po thotë kështu dhe këtu nuk mund të ndryshosh asgjë. Kjo nuk është dashtë me qenë në rregullore tonë hiq ne tash po miratojmë një rregullore e cila është e bazuarë në një nen komplet i përshkruar nga ligji, ne jemi nivel me i ulët. Letë te mbetet si është ose të hiqet krejt nga Rregullorja.

Misin Berisha - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyetje a ka mundësi për vdekje me e hijek krejt me e bë pa pagës, po e shohë që ka mundësi, le të na sqaron dikush me mirë a kemi te drejt.

Besa Ferati - përshëndet të gjithë të pranishmit, a ka mundësi ne mos me miratua hiq këtë rregullore sot dhe më lyp sqarime shtesë për këtë pik se kjo nuk ka me shkuar barabartë dikush ka me paguar 20 e dikush 50 kështu që me e mira është me u shty e me lypë sqarime shtesë. Ose me kushte qe të kemi sqarime shtesë

Kryesuesi - mund ta miratojmë më kushte që nga ministrit e linjës ne të kërkojmë sqarim si mund të vendosim me komisioni që kjo rregullore mos te kthehet prape në kuvend.

Zekie Sutaj, udhëheqës e zyrës ligjore, përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi erdhëm në këtë situatë kështu, ligji është i miratuar në kuvendin e Republikës së Kosovës ne nuk kemi qare pa e zbatuar edhe pse ka hapësira dhe është i pa kuptueshëm në këto dy pika, kërkoj nga ju që ta bëni një rekomandim në Kuvendin e Republikës së Kosovës që këtë Ligje më plotësu -ndryshu, për momentin kjo duhet të shkoj kështu siç është.

Mirushe Sadikaj - po thotë këtu është e përcaktuar afati kohor sipas ligjit e ligjin zyrtarja që e bën pagesën e ka përpara dhe thotë nëse je vonuar 2 muaji i ki 50 nëse 3 100 a është e caktuar me ligje, a ekziston aj afat kohor në ligj.

Kryetari i Komunës - nëse me ligje është e ndamë me afate kohore nuk kemi çka diskutojmë këtu, a ekziston kjo.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe 3 abstenime miratoi Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba.
Në procedurën e votimit ishin 24 anëtar të KK prezent.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2019, Enver Rugovaj,

Enver Rugova – bënë prezentin dhe sqarimin e Raportit vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2019.

Arif Elshani - e falënderoj Enverin për këtë rezime që na dha por mendo që këtë është dashur të na jap drejtori me na tregu pak për gjendjen edhe pse ne e dimi kjo është një gjendje e keqe për ndërmarrjen ne sa me shumë së e zvarritim këtë çështje unë mendoj se asgjë nuk bëjmë ky e ka propozon në fund edhe falimentimin, këtu është edhe Kryetari i Komunës dhe mendoj që nuk duhet të falimentoj një kompani për 27 mijë euro ajo nuk është vlerë aq alarmante që ne është dashur më u leju me u falemintu, që pas falimentimit janë disa pasoja por çka është me e keqja njerëzit atje janë pa paga, propozoj që në këtë Kuvend së pari Kryetarit të gjëj një zgjedhje dhe kjo të sanohen këto humbje që i ka kjo ndërmarrje dhe të gjendet ndonjë metode tjetër përndryshe nuk është e rrugës që ata njerëz me vite të jesin pa pagë.

Agim Avdijaj - edhe kjo tema e stacionit të Autobusëve për bese qaç u bë dyqysh bajat sa që s'po di as ka mija nis bisedës me të ajo çka kam mund ta vërej unë janë dy çështje kryesore që nuk po funksionojnë fakti që është skaduar mandati i bordit menjsoj që është problemi kryesor si kuvend komunal dhe si ekzekutivi.

Kryesuesi - nuk e zgjedhim ne por komisioni i aksionarëve.

Agron Avdijaj - kush është komisioni i aksionarëve. Se me statut aksionar 100% është komuna ne jemi aksionar, edhe pse aty i referohet aksionaret në shumës unë s'po e di kush janë aksionarët.

Në këtë rast është përgjegjësi e komunës e Kuvendit me e caktu bordin e ri e bordi i ri me këqyr ne konkurs edhe nivelin ekzekutivi ku po qalojne. Problemi i dytë është tek financat financat po lidhen me pa mundësin e inkasimeve për mu është shqetësuese tarifa e lartë tarifa e ulëte por përderisa i vetmi operator ekonomik në Istog nuk e pagunë që e ka më të ulët e në Pejë e pagunë që e ka më të shtrenjtë nuk është problemi të operatorë pot të ekzekutive ose të mekanizmat tjerë që besoj duhet me u identifikua kush ose inspektoriati ose kushdo qoftë ato që pse në Pejë e pagu me sepse nuk guxon me u ndal në trotuar se gjobitet e në Istog jo, dyshimi im është që kompanitë kanë ndërlidhje edhe me aspektin e policisë. Duhet të lëshohen gjoba në këtë drejtim gjobite një here atë e me ato gjoba i kryen disa obligime ajo kompani. Detajet tjera nuk po hi në raport, falimentimi nuk është zgjidhje, e kam përsëritur edhe para disa muajsh se qëllimisht po lehet me ardhë në atë situatë që me qitë në falimentim.

Labinot Alijaj - me vëmendje e kame lexuar të gjithë raportin, krye shefi të pjesa e mos arritjes së objektivave fajtor kryesor e bon KK ku thotë së pas uljes së tarifave është humbje, sa e kame vërejtur unë pas uljes së tarifave ka regjistrim më të madh

të numrit për peromave e kundërta çka thuhet, kur flet për periudhën maj qershor në raport thuhet që ka kompani të cilat kanë operuar për linjat verore që janë Ulqin, Shqipëri ndërsa në njërin anë thotë asnjëra nga to nuk e kanë bërë peronizimin ndërsa me vonë thotë që njëra nga to e ka bërë dhe nuk e jep cila, nga kompanit, në anën tjetër në raport thotë që nuk ka evidence se sa kompani. Nuk ka sa kompani operojnë në linjat urbane dhe ndërkombëtare asgjë nuk ka sjell me na tregu çka është e sakta por vetëm akuza. Thotë që nuk kemi bërë auditim të jashtëm sepse nuk kemi fonde në muajin korrik janë dhen 30 mijë euro dhe pikërisht në këtë muaj pasi i ka marrë paratë thotë që nuk kemi pasur fonde më e bë auditimin e jashtëm, për auditimin e brendshëm thotë që me ka premtua drejtori, ku drejtori po thotë kemi një bashkëpunim shumë të mirë në të kundërtën thotë që ka bërë dhe ka marrë fjalën, në shumë vende po bie ndesh me atë që e ka thënë vet kështu që kërkoj që të na sillni një raport me të mirë herëve tjera dhe me me pak gabime gjysorë.

Zenel Shatri - gjendja e Stacionit të Autobusëve me të vërtetë është bërë histori jemi duke biseduar edhe në asambles e kaluar edhe tani gabimet mundohen me ja dhen her komunës her drejtorit here ekzekutivin por gabimet i kemi të gjithë nën 1 unë jam që të dilet me një planë Kryetari me ekzekutivin të bëhet një Planë me mënyrën se si mund të dilet nga kjo gjendje si është Stacioni i Autobusëve sepse unë personalisht nuk jam që Istogu të mbetet pa Stacion të Autobusëve, gabimi është se ne na u ka thënë se kur të zgjidhet një inspekto i komunikacionit, zgjidhet problemi po me duket kurrëgjë prej asaj nuk pat e dyta bordi komisioni i aksionarëve bordin nuk e ka zgjedhë që një vite edhe aty lë të bartin ata që e kanë bërë gabimin mirë po ne si Kuvend i kemi dalë dy tri herë në ndihmë edhe unë personalisht jam që me mbet Stacioni i Autobusëve.

Lavdie Bujupaj - pyete shoh një borxhë nga ana e ATK-së prej 9032 euro për çka është ky borxhë cilës periudhë i përket borxhi.

Mentor Vuthaj menaxheri i Stacionit të Autobusëve, po hi në mënyrë kronologjike me ju përgjigj pyetjeve mas pari unë nuk kam lyp me likuidua nëse e keni lexuar qartë.

Këto janë borxhe TVSH-ja për vitin 2019, tatimi në burim për vitin 2019 është trusti pensional prej muajit 7.2018 dhe komplet viti 2019 dhe kjo për çdo muaj rritet së janë ndeshkimet dhe interesi.

Kryetari i Komunës - ne po e shohim raportin dhe e dini gjendjen ashtu siç është po i shohim rekomandimet që janë dhen me herët nuk po e shohë as një ndryshim, qëndrine përsëri aj rekomandim, pajtohem plotësash që falimentimi nuk do të ndodhë, masat duhen të merren, bordi të zgjidhet sa ma shpejtë që është e mundur të përfundoj, me një vendim të marrim veprime të ndajmë mjete shpesh sa të aprovohet edhe buxheti ti sjellim në zero dhe nëse e bëmë në zero dhe në vitin tjetër vimi përsëri në këtë situatë atëherë nuk kemi bërë asgjë Edi që nuk është lehtë ka plotë ndërmarrje publike në gjithë Kosovën që janë në gjendje shumë të vështirë dhe

subvencionohen mbulohen nga format tjera nga shteti, mendoj që kjo do të zgjas, ti rregullojmë edhe tarifatat posaçërisht nëse drejtori garanton që bëhen stërkut pagesat, besoj që mundet me u bë të këtyre tarifave të parapara edhe me Rregullore. Ju anëtar të kuvendit jeni themelues së bashku të marrim pasi jam me e ruajt Stacionin e Autobusëve me e fuqizu dhe me qit në rend. Nuk mund ta shohë Istogun të këtë një lëvizje kautike. Se në të gjitha hartat e komunave figuron një Stacion i Autobusëve, ajo është edhe tek ne.

Misin Berisha - pyete kjo ndërmarrje a mund te mbijeton me të hyrat e sajë.

Mentor Vuthaj - nëse nuk rriten tarifatat jo.

Ajshe Metaj - ne faktikisht jemi mundu që me uljen e tarifës jo ti bëjmë dëm stacionit të Autobusëve por ti polenizojnë me shumë dhe te fitojnë këta nga ana tjetër na është munduar në të mirë të Stacionit Të Autobusëve sepse as ne nuk jemi qe më falimentuar, edhe pikërisht atëherë u thirrshim në pa rregullsi që nuk ka inspektor, inspejtori tash është po ku është puna dhe rezultati i inspektorit a ja ven që aj inspektor që po operon me marr një pagë mujore sa shohë unë Autobusët përsëri janë mbi trotuare sidomos në vendin ku shkohet të qendra tregtare banana center Autobusi është aty ku është inspejtori pse nuk ka gjoba. Nuk është tu u ndreq asgjë. Komuna me kërkuar llogari nga ato që po i jep se si po shpenzohen.

Mirushe Sadikaj - nuk është rendi për falimentim bordi nuk është funksional shefi ekzekutivi nuk ka ndikim ne ekzekutivi aspak, ata që janë përgjegjës për zgjedhjen e atyre të zgjedhën menjëherë, gjendja jo po përsëritet po jetë edhe me e keqe se përpara tarifatat mujnë u rrit vetëm se 100% me hy autobusë ne stacion.

Agron Avdijaj - kërkoj a ka kontrata me operatorët stacioni i autobusëve. Sepse me ligje është dashur të kanë kontrata me kompanitë. Dhe nëse nuk ka kontratë mos me ja dhan lejen e funksionimit kur të bëjnë këtë pastaj më përmbarues jua merr parat. Nëse kjo bëhet s'kan qare pa i paguar.

Kryetari i Komunës - për territorin e Komunës e kanë lejen nga Komuna te operimit. Ndërsa lejet nderkomunale i kanë nga Qeveria, me këto kanë obligim të hynë Stacion.

Mentor Vuthaj - Stacioni me operatorët nuk ka kontrata. Nuk kanë mekanizëm ligjor me i obliguar me bë kontratë.

Zenel Shatri - kryetari i sqaroj ku i marrin lejet e ka i kanë stacionet e kush jua cakton. Kur operatorët dojm me u licencu a licencohen për çdo vjet ata a marrin licenca nga Ministria ata qe janë nderurban apo në 4 vite. E dyta kur aplikojnë për licenc me marr rendin e vijave a ju lypet një dokument që ata i kanë majte vijat dhe

nëse e kanë majtë nga Istogu me çka e kërkojnë a ka bileta a çka. Se nëse se kanë linin nuk hyn në Stacion, a kini kështu obligimesh ju që mund të kushtëzoni ju.

Mentor Vuthaj - në bazë të ligjit jam i obliguar me raportuar në ministri të Infrastruktura në bazë tremujore, dhe tre mujorshin i fundit ka shkua. Nga Ministria me të 20 të gjithë operatorëve u ka skadur rendi i udhëtimit a ja vazhdojnë a jo nuk jam unë aj, nuk e di kush në Ministri guxon me ju vazhduar vijat në bazë të raportit që kam dërguar, ta shikojmë. Raporti është i detajuar bazë ditore në bazë të linjave me orë.

Lavdie Bujupi - pyetje më intereson me ardhjen e inspektorit Avdiqaj në kompani a është gjendja e njëjtë a ka përmirësim mos ish deshtë edhe këtë problem me shqyrtuar si kompani.

Mentor Vuthaj - masë pari nuk ka ardhur në kompani aj, është në drejtorin komunal po e kryen punën e vet a ka sukses a jo është raporti.

Lavdie Bujupi - mirë por edhe aj është prezent aty dhe ju duhet me e ditë a po e kryen punën mirë.

Mentor Vuthaj - nuk është kompetencë e imja me vlerëso inspektorin.

Lavdie Bujupaj - mirë po duhet me kqyr ku është gjithë ajo ngecje në atë kompani. Dikund është problemi.

Labinot Aliaj - Kryetari tha që linjat urbane merret leja në komune ndërsa në raport kryeshefi thotë se nuk kanë evidence sa linja janë. Sa i përket Inspektorit krye shefi thotë që pas ardhjes së tij në detyra nuk ka ndonjë përmirësim. Pyet, me statistika tina sa here e ka njoftuar inspektorin se po parkohen autobusët jashtë Stacionit dhe sa here e ka njoftuar se nuk po peronizohen.

Mentor Vuthaj - shkresat janë që jua kam dërguar, ndoj here në bazë ditore apo edhe javore shkresat janë të protokolluara janë të njoftuar drejtori i drejtorit dhe Inspektori.

Krzesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë në pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimeve (01Nr.44/2020 dhe 01 Nr. 45/2020) të Kryetarit të Komunes për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim me negocim,

Kryetari i Komunës - bënë prezentin dhe sqarimin e Propozim - Vendimeve (01Nr.44/2020 dhe 01 Nr. 45/2020) të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim me negociim,

Naim Imeraj - kalimthi u bë e qarte dhe ata që kanë pasur pak vullnet me e trajtu propozimin e vendimit e kanë pa që referimi është te ligji që ka hyne fuqi në prill të 2019 mbi dhenjen në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, nga pozicioni im e vlersoj që ky ligj ka avansuar në raport me ligjin paraprak dhe ka lehtësuar që ne të krijojmë një ambient me të volitshme për zhvillimin e aktiviteteve biznesore ekonomike në pronën komunale tu u nis nga prona Komunale në K. Istogut ky ligj me nenin që ju ka referu në propozim vendim kryetarit të komunës i jep kompetenca për negociim për të cilat unë besoj që janë lehtësim i madhë procedural dhe si të tilla i shpejtojnë proceduar burokratike të cilat kanë qenë përpara pavarësisht që ka dualizem e kanë mbet edhe ato procedurat e perparshme të ankandit e tjera por prap se prap e drejta e negociimit të kryetarit është e pa diskutueshme po ashtu ky ligj i jep të njëjten kohë edhe obligim komunës në një nen e përgjithshëm Kryetarit të komunës për mbikqyrjen e realizimit të kontratave Kryetari e tha haptas tu u referu me siguri kësaj materie që do të jetë këmbngulës në përmbushjen e këtij obligimi, kaq për bazën ligjore, sa i përket dokumentacionit të dhënë në këto dy propozim vendimeve po nisna prej propozimit Nr.44/2020 që ka të bëjë me parcelën Nr.136-9 zona kadastrale Gurrakoc, projekti ideor që na është dhënë me të vertet është një projekt i punuar në mënyrë profesionale si nga ana e shkoqitjes së materies po ashtu edhe nga ana financiare ajo qka ne këtë projekt e duke ju referuar propozim vendimit ka diskrepancë është qështja e sipërfaqes parcelës Nr.136-9 ka sipërfaqen përgjithshme prej 1135 m² përkatsish 19 ari e 35 m, ndërsa në projektin ideor i cili e përfshin edhe planin e biznesit të cilit thashë është me të vertet i punuar në mënyrën me të mirë të mundshme investitori potencial e jep vetëm bazën e objektit në sipërfaqe më shumë se 1000m² e cila realisht në aspektin fizik aj objekt si na është dhënë në dokumentacion nuk mund të futet në atë parcelë, tash ku është problematika besoj që do të përgjigjen kompetentët ose kryetari përmes njerëzve kompetentë problematika është që është në stacionin hapësinor është dhënë një objekt i cili ka gjetësinë më të madhe sa secili kënd, është e pamundshme fizikisht me futë brenda asaj parcele edhe sipas gjendjes së propozuar nëse ka qenë ajo në negociim ka qenë ajo një hutim, ku është problemi nuk mund të them diçka sipas një situatacioni pavarësisht se kryetari e tha që do të vazhdojnë procedurat vazhduese. Ne sotë përpara e kemi një dokumentacion i cili është i pa realizueshëm situacioni që e ka dhënë në projektin ideor sepse bazën objekti e ka 1003m² saktësisht ndërsa nuk mund të futet. Mund ta deshmoj edhe me një skicim i cili besoj që të kompetentët veç e kanë pa se ku është problemi, qka mundemi ne me bë nëse është pretendimi me u shfrytëzuar një hapësirë me e madhe se kjo në 1135m² atëherë nuk është në rregull ndaj Kuvendit të komunes sepse ne jemi autoriteti që e miraton atë, nëse është gabimi tek investitori në shfrytëzimin në iden atëherë investitorit ka me i dalë telashe edhe me etazhitet që nuk po dua ti dhë tash ide, se objektin prej 1000m² aj nuk mund ta fut aty por duhet që 290m² i kalojnë në një

parcel e cila është ngjitas për objektet egzistuese në qëndren zejtare në gurrakoc 290m2 të atijë objekti që po i bjen që aj mund ti fut aty vetëm 700m2 me ni konfigurim tjetër po normal që kemi edhe kufizime së është zonë urbane edhe kemi kufizime urbanistike ajo qfar kemi. Qka po du me than unë këtu, aktvendimi nëse është negucu kjo parcel situacioni është jo kompatibil dhe duhet prej investitorit në procesin nëse kuvendi kumunal përkatësisht Kryetari si bartës i procesit të negucimit thotë që do te shqyrtohet ky problem atëhere mbetet që investitori ta riporpujoj iden 10 vite punoj në industrin e perpunimit të ushqimit përkatësisht langjeve baza 1000m2 për atë industri e me këtë pershkrim biznesor është relativisht modestë etazhitetin ja cakton negocimi, plani urbanistik apo zhvillimor cili është në fuqi nëse e ka Gurrakoci urbanistik poproblematika është që këto 1000m2 aty nuk hynë edhe mos të mundohet dikushme i shti ato aty për shkak së kryetari e tha jon kofencat që i përcakton neni nga ligji që nuk mundet me ju dhën leje në një parcel të cilën ne nuk e kemi dhën mos të tingelloj se po boj teke ose kam ndonjë ide tjetër ideja është shumë e mirë edhe ma mirë kish qën mi par aj edhe 50 ari aty ose 1 hektar edhe ma mirë po si ja ka qit renin e din investitori vet fakti që është i gatshëm me i shti 2miljon euro në atë biznes për ne është e mjaftueshme me mendu që është një aktivitet edhe tek e fundit një objekt i ri aty qof tash në dy etazha apo 3, brenda kushteve urbanistike.

Destinimin e kërkon ligji, atë që e përcaktojm ne në vendim është destinin dhe ne nuk mund ta ndërrojm procesin e negocimit ne nuk mund ta ndërrojm, investimin që është përcaktu në bazë të planit ideor kryetari i komunës i ka te gjitha kompetencat kerkoj që të negociohet qështja në aktvendim qështja e sipërfaqës së 2000m2 objekt e nuk dihet qka mendohet mendoj që është bruto 1000+1000 së 2000 nuk ka ku e qonë nëse i kufizohet me etazhitet bruto që të dihet. Qka është e pa pranueshme për mu është që në parcelen komunale naser pasneser të na mbin një objekt banesor afaris në kuptimin e asaj që ne jemi tu bë diqka në kuptimin ekonomik të komunës për mu është e pa pranueshme qdo gjë tjetër që gjeneron numër puntorbe rritje të puntorve qoft primar apo sekondar është e pranueshmë. Faliminderit për durimin dhe mirkuptimin.

Agron Avdijaj - e përcjella me vëmendje edhe Kryetarin arsyetimin ligjor që beri, po ashtu e vlerësoj edhe prezantimin e kolegut Naim , ku me thën të drejten paktone plotësisht ku një pjes e tyrë në atë nivel nuk ë kam bër analizen kur e kom pranu imellin me këto dy dokumente kam thën vota ime do të jet po për të dyat edhe pik. Edhe pse pershkrimi edhe plani ideor gjenerimi i punësimit dhe të gjitha ato nuk e kam pa si tem fort deri sa kamë hy me hulumtu për projekt propozimin për këtë qëndren multi funksionale grumbullimi dhe funksionimi i pëmeve dhe perimeve konsideroj që këtë biznes është dasht Kryetari me ja propozu një lokacion tjetër pse jo edhe me të madh se sa aj lokacion aty nëse me të vertet e ka pasur investim biznesoor këtë qështje edhe rigjenerimin e punëtorve aty sidomos edhe për llojin e veprimtaris këto që i përmendi Naimi vendosja e objektit në atë hapsir aq të ngushte kur kësaj i shtohet hapsira për parking aty do të jët hyrje dale, është stacioni i autobusvë afer është kogja problematikë për mu qështja e lokacionit edhe në

studimin e fizibilitetit që ju ka referu në planin ideor një prej qështjeve kur diskutohet në arsyshmerin e projektit specifikohet krahas lokacioni quditrish as propzim vendim nuk është arsyeu se lokaconi është i favorshem i përshtatshem, por as nga vet investitori nuk është cekur si njëra prej pikave ku ka favoritet për biznesin për llojin e veprimtarisë në atë lokacio. Ndërsa pika kyqë kurë të prezentohet kjo është lokacioni qikjo është ajo që për mu është shqetësuese në rastin konkret, edhe si Agon edhe si LVV madje kemi marrë edhe kërkesa nga qytetaret që një gjë e tillë nuk është mirë me u përkra në atë lokacionë tash rritja e vlerës së pronës komunale në atë rast nuk e di qka rritet vlera ndoshta dikund tjetër po amo jo në këtë kategori. Në kopjen e planit kategorizohet si livadhë klas e 4 nuk e di a është e sakt kjo por mu me duket se nuk është livadhë aty. Ana tjetër 20 ari në qëndet të Gurrakocit unë e konsideroj si qënder urbane aty edhe pse është fshat por e konsideroj si të tillë vlera e kompensimit edhe pse nuk jame me rrit vlerën biznesi që investon me dhënë pare.

850 euro në vitë që i bjen 75 euro në mujtë për një veprimtari të tillë ku për mendimin tim është shumë e vogël, kam marrë pjesë edhe vetë në këso madje edhe në zona ekonomike kur janë bërë madje edhe kur janë dedikuar me hapsira me biznes paguajnë qira më të mëdha se kaq e le më në një ambient të tillë. Pak a shumë këto janë ato dilemat e mia edhe nuk e di a është dashur me u cek në propozime vendim apo në kontrat pasi e ceku kryetari kur të bëhen këto farë rreziqet potenciale ndërrimi i destinimit e krejt ndoshta kish qenë mirë cek në paragraf ndërrimi i destinimit faktikisht nënkupton ndërprerje të punës dhe mos lejimit të vazhdimit të punës, nuk e di juridikisht si shkon kjo punë.

Ndërsa sa i përket biznesit tjetër të panelave të ndërtimit të shtëpive të drurit meqëse ai pak a shumë tash e ka një pjesë aty jamë për me përkrah por nëse qiten në votim mendoj që dy propozimet duhet të shkojnë në votime të ndara, kam dilemë në japsirën 1 hektar mu duk pak e madhe të zona industriale për këtë kompani por megjithatë plani i biznesit gjenerimi i punësimit dhe lloji i natyrës së biznesit që është diçka që nuk prodhohet për momentin në Istog është inkurajues dhe jam me e përkrah madje edhe lokacioni është i arsyetueshëm, në këtë rast nuk kam dilemë sa i përket lokacionit këto janë ato shqetësimet e mia.

Labinot Alijaj - nuk kisha dashur me u leshu në ato që veç u thanë kam vetëm dy vërejtje sa i përket investimit që është thënë se është 2 milion, aty shihet në bazë të planit të biznesit që është 1 milion e 119 mijë në rast se ai investon në përpunimin e marmelatave dhe reçelrave, d.m.th. nëse ai nuk vendos atëherë i bëjnë 1 milion e 60 mijë euro investim edhe të pjesa tjetër ku thotë që do të punësohen 50 punëtorë baza të organo gramit që ai e ka ofruar janë 15 punëtorë me menaxher. Unë sinjoralisht dua ta lë këtë punë nëse kryetari vendos që sot me u votua kjo pa u kaluar pas atyre kritikave që u dhanë nga zotri Naimi dhe nga Agroni unë në emrin tim dhe të Arbenit në do të votojmë pro kësaj por lë të mbetet tek ju të vendosi se a është mirë me kaluar sot ose jo.

Arif Elshani - kam për kryetarin dhe mënaxhmentin sidomos projekti ne Gurrakoc dhe projekti tjetër të mbikëqyren mirë në mënyra strikte dhe ato projekte të realizohen ne kemi me i votu këtu në vitin 2014 një projekt riciklimi i mbeturinave që mendoj që ende asgjë nuk është bërë, nëse epen ato parcela që janë shumë me rendësi për komunën tone letë përcillen në mënyra strikte në baza 6 mujore vjetore dhe të realizohen ato projekte nese ne po i votojmë, por jo të epet parcela toka të qitet në emër të vet dhe mandej ata njërez mos të merren me atë. Kërkesa ime strikte është që të përcillen me shume përgjegjësi ato projekte sidoqoftë i mirë i keq aj projekt letë realizohet.

Kryetari i Komunës - nuk kam çka ti shtoj po shohë droje që është shumë normale, mirëpo një gjë e di që këto nuk ka të bëj, vet kërkesa është qendër multi funksionale ideja nuk është me bë qendër banesore ne për qendër banesore nuk kemi të drejt me bë në këtë formë ligji i përcakton qarte të drejtat tona. Kemi kërkesa në qendër aty i kemi dy objektet e vjetra Arifaj është një edhe Avdiqaj nuk e di bash mirë, ata kanë kërkuar në këtë formë me shku, ne nuk kemi të drejt aty arsye aj po donë me bë banës aty një kat poshtë ose dy kate lokale edhe banim, nuk parashihet me plan rregullativ aty.

Duhet me gjet formë tjetër partneriteti aty. Me u ul dhe me bisedu ato janë objekte të vjetra duke u rrëzuar, duhet më bë objekte të reja si janë bërë tjerat, prandaj të shohim çfarë koncesioni duhet bere, edhe në baza ligjore si i kemi mundësit.

sa i përket hapësirave çdo objekt që ndërtohet këtu etazhitietin e atij objekti afarist multifunksional duhet të bazohet në planin rregullativ duhet të jet sipërfaqja e vendosjes së objektit konform planit rregullativ sa është ajo 50 objekt 50 hapësira a 60 n'varet si parashihet aty, këta drejtorët Luli e Jashari e dinë mirë këtu është aj problemi, nuk e kisha pru propozimin për objekt banesor, edhe 2 jam bazuar që propozim vendimi që ju e kini këtu të jetë stërkit i bazuar në ligj. Për kontratën që do të jetë pas këtij vendimi atëherë jemi konsultu jo vetëm me struktura brenda por do të marr edhe forma si e kanë bere të tjerët çfarë standardesh duhet për me u vendos një kontratë e tillë tek atëherë vjen leja e ndërtimit e cila duhet të jetë po ashtu konform ligjit.

Ndërrimin e destinimit mund ta bëj në një faza por as një here banesa por mund të jetë një tjetër biznes i cili i doket me i mirë edhe aj biznes nuk mund të jetë i çfarëdoshëm së është hapësira e tillë është një biznes i cili e dekurajon edhe Gurrakocin e ka një pamje e cila i ka hije një pjese urbane kështu është ideja nuk po dua me deformua aty me bë llagëm për punime e me gjuajt aty arra molla me mbush pllacin. Nuk është kjo ide nuk besoj qe e ka as aj s'ma merr mendja, numri i punëtorve, për me pas mundësi me marr në shfrytëzim aj duhet me investru shumë prej 10% të investimeve kapitale që i ka pas komuna vitin paraprak. Numri i të punësuarve nuk mendoj që mund ta obligojmë ne se ndoshta nuk ka mundësi me i punsu 15 a 20 po i punëson 5 a 6 si fillestar kjo është një çështje se nuk mundësh në kontrat me ja precizu këtë.

Për çmim vjetor Agron edhe mu po me duket pak po s'po dimi as qysh me ja dhëne, ideja është mos më i mundu me këto ngarkesa më qellim të zhvillimit, ka vende që i

dhëne pa parë krejt, kame kërkesat të tilla shumë, kam kërkesa për dhenjen në shfrytëzim në bazë të këtij ligji.

Komuna ka rastin kur e kemi dhëne token në shfrytëzim për riciklim, ndërsa toka shfrytëzohet në mënyra bujqësore mbjellët kush ka interes për ndonjë biznes tjetër aty at vendim e shfuqizojmë aj e ka pas një afat kohore, edhe këtyre ka me ju dhëne afati kohor, përndryshe nuk mund t'i lenë peng ato pronë. Dilema ka edhe unë kam dilemat e mia mirë po çdo dilemë po dua ta kem të bazuar në ligj, nuk po dua ta qes veten as ju ne telashe.

Naim mos të lidhemi stërkit në këto sipërfaqe që i ka be ky se ky këtë s'ka qare pa e ndryshuar se nuk mundet me ndertu jashtë parcelës se po jepet në shfrytëzim.

Naim Imeraj - ata çka e thash është qeshte se çka me bren, edhe e them publikisht se tek e fundit kemi dhen një betim, nuk jemi tu repliku po po dua për anëtarët e kuvendit komunal koleget këtu, duke qenë se vet fakti se jam futur në këtë materie të ligjit pa shmangshëm që ju e dini atë punë që neni 22 i cili përcakton obligimet e komunës përkatësisht kryetarit të komunës e ta ngarkon një barre në raportin 6 majorësh duhet të përfshihet, raport i veçante për zbatimin e kontratave në dhenjen në shfrytëzim nuk e di a të kanë sugjeruar zyra ligjore po është e precizime edhe e dyqane rast të shmangies e keni obligim ligjor neni 22 pika 4 kryetari obligohet që për shmangej të qëllimit të shfrytëzimit të njoftoj Kuvendin me shkrim dhe ti propozoj rekomandimin e tij për shkëputjen e kontratës përkatësish për masat e caktuara si njoftim për anëtarët e KK. As një raport se është obligim me e ditë.

Kryetari i Komunës - për ndërrimin eventual në rrethana pas 2 apo 3 vitesh për ndonjë eventualitet, ky e ndërton objektin këtu i bën makinat nga Gjermania, nuk i funksionon biznesi i hjek ato makina i bijën tjerat gjithësesi duhet të informohet kuvendi duhet të bëhet kërkesa shtesë në Kuvend, kështu thotë edhe ligji.

Agron Avdijaj - dilema jem është pikërisht për llojin e veprimtares në lokacionin e caktuar, tani po deklarona se unë duhet me votuar kundër këtë pikërisht për shkak se mendoj sinqerisht lokacioni nuk është i përshtatshëm për at lloj veprimtarie madje kisha qen dakord me propozuar një lokacion edhe ma të madh se 20 ari dikundë tjetër po sidoqoftë është vendim i kuvendit.

Kryetari i Komunës - kam parë fabrikë të çokollatave në qendër të Vjenës një vend as 30 ari vend. Veprimtari me lokacionin nuk është problem.

Kuvendi me votim 21 për, 2 votë kundër dhe 1 abstenime miratoi Propozim – Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.01- 44/2020 për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim me negocim, Në procedurën e votimit ishin 24 anëtar të KK prezent.

Kuvendi me votim 23 për, pa asnjë votë kundër dhe 1 abstenime miratoi Propozim – Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.01- 45/2020 për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim me negocim, Në procedurën e votimit ishin 24 anëtar të KK prezent.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tetë të rendit të ditës: Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020,

Enver Rugova – bënë presentin dhe sqarimin e Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020,

Ajshe Metaj - ne e dëgjuam kryetarin, për shkollat për institucionet publike me duket së Ministria menjëherë ka reaguar dhe ka nda mjete me i rregulluar ato dëme. Janë në pyetje edhe dëmet për individët privat. Por kur flitet për shkolla unë kisha propozua që me u procese me procedura me të shpejt mbulimi i shkollave, pasi që edhe kushtet klimatike janë prish edhe shkollat po pikojnë në gjitha anët ashtu flas edhe për gjimnazin e kemi pa edhe shkollën në Vrellë në Kaliban është siç e kemi parë të gjithë mes mediave kisha kërkuar me u përshpejtuar procedurat aty ku kanë me hy nxënëset dhe faktikisht koha është ftohë. Të veprohet diçka ma shpejt sepse procedurat e tenderimit zgjasin e koha nuk pret. Pyete drejtorin e bujqësisë e kuptova që nuk kanë nda mjete për bujqësi, a do të subvencionohen serat e dëmtuara apo jo sepse këto e kanë një afat të kufizuar për mbjellje.

Kryetari i Komunës - tenderët janë dal nuk mund të ja mohojmë të drejtën e ankesës askujt. Ne kemi filluar negocimin me disa kompani që në raste emergjente mund të japim një kompanie pa procedura tenderimi por Ministria e Financave ka ndërhy nuk duam ti qesim në lajthitje as Ministrin e Financave as atë të Arsimit. Mësimi po vazhdon nuk ka ndërprerje të procesit mësimor, shkollat që do të kenë dëmtime do ti lyejmë nuk do ti lemë keq.

Agron Avdijaj - pyet, nuk e di qysh është gjendja me ndërtesat sociale aty ka pasur dëme mendoj që është kategori me e ndjeshme, edhe nuk e di këto rastet tjera sociale të shtëpive që kanë pas dëme ndoshta këtu ish dashtë me pas pak fokus ndoshta komuna edhe këto tjerat të mbesin sipas fondeve.

Slavisha Maliković - Une kam nje pyetje per Drejtorin e Bujqesise. A eshte e mundshme qe vet qytetaret te financojne ne riparimin e serave pasi qe 99 % jane te demtuara, dhe veq se kane filluar me mbjelljen e fidaneve, dhe a mundet Drejtori i Bujqesise ti kompenzoje ata bujq me para e jo me najlona, nese do te jete e aprovuar nga Ministija e Bujqesise, pra bujqit mos te presin por te fillojne te punojne:

Enver Rugova - drejtorati për Shërbime Publike pasi që i ka identifikuar rastet me të renda 15 raste kemi intervenuar me fondin emergjent që është në kuadër të

drejtorisë, kemi intervenuar në shtëpitë shumë të dëmtuara nuk i kemi këqyr kategoritë sociale po me i strehu njerëzit që kanë mbetur podrumëve apo kanë shkuar të afërmit e vet kemi pas raste , kryesisht në kulme deri në raste drastike me hjekje të kulmeve kompletë, është intervenu neper ato shtëpi shumica janë intervënu janë edhe dy raste aty jemi tu i shikuar mundësit si mu intervenu fondi nuk është i madh edhe është afër deri të shpenzimi i tij në shikojmë edhe më vullnetin e juaj ose me rishikim ose një formë tjetër që të ndaj mjete për at fond sepse emergjencat që jemi dëshmitar. Së bashku me drejtorin e Shëndetësisë kemi intervënu në kulmin e shtëpisë së shëndetit në Istog që ka qenë bukur i dëmtuar dhe kemi intervenu në dëmtimin e katër shkollave, demet e mëdha në shkollat tjera ne nuk kemi kapacitete mi evidentuar. Të rastet sociale janë të paraqitura në kuadër të dëmeve që janë bërë në ministrin përkatëse dhe në qeverinë e Kosovës janë të dërguara dhe po presim fondet.

Naim Behlulaj - e dëgjova drejtorin që tha po intervenojmë në shtëpitë që ju ka hjek qatia të gjithave dhe ka që se ka përmend në Uçë Arsim Imeraj që komplet kulmin e shtëpisë ja ka hjekë nuk e di sa keni marr masa kërkes ka bërë dhe zyrtaret e drejtorit i kanë thënë nëse ke mundësi ose bën ndonjë zgjidhje dhe në të përgjigjemi, aj ka marr borxhe në një firmë këtu në Istog materialin dhe e ka rregulluar kulmin, ka fotografat, dhe jemi dëshmitar të gjithë ne.

Ajshe Metaj - deshta me pyete drejtorin a bon me ditë në cilat shkolla ka intervenoj se kini konsideruar së janë me emergjente. E kuptova këtë se nuk ka më mjete nga fondi emergjente dhe kërkoja që këto tjerat çka u bë.

Hajrush Shoshi - drejtor i Arsimit - përshëndet të gjithë të pranishmit, kryesisht është intervenuar në shkollën e Dubravës ku kanë qenë tjegullat e hekura, shkolla në Llukafë , Studenic dhe në Prigodë këto janë shkollat me sasi më të vogël të tjegulla dhe kemi intervenuar shpejt.

Kryesuesi - po kthena pak të propozimi i kryetarit që na tha, mund ta formulojmë ne si Kuvend Komunal një kërkesë - shkresë që të apelojmë të niveli qendror së Istogu të ketë një përkujdesje pak ma të madhe në këto raste së çdo here po kemi dëme të mëdha, kjo të mbetet nga administrata nëse shihet e udhës të apelohe me një shkresë.

Kryetari i Komunës - ju merrni vendim këtu që të apelohe në organet përkatëse përkrahje e dëmeve që është shkaktuar nga era e fundit.

Kryesuesi - nuk po di si ta quaj atë Vendim apo kërkes për mbështetje.

Kush është që të bëhet ky apel për Qeverinë e Republikës së Kosovës që në afat sa më të shkurtër për mbështetje financiarë.

Në mënyra unanime miratohet

Kuvendi Komunal apelon që sa me shpejt të bëhet kompensimi i dëmeve nga erërat në afat sa me të shkurtër.

Shqyrtimi i pikës 9

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Slavisha Malinković - Une kam një pyetje, duke e marrë parasysh se ka pas shpronësime të tokës për largperqesit, shumë qytetare të Komunes së Istogut nuk janë kompenzuar, edhe pse Kryeministri Isa Mustafa në atë kohë ka garantuar se do të ketë kompenzim për të gjithë ata qytetare, dhe ende nuk kanë marrë kompenzim, a mundet Komuna apo Drejtoria në ndonjë mënyrë të përgjigjet këtyre qytetarëve në ndonjë mënyrë apo ndonjë lloj ndihme. Pasim që ka veq 4-5 vite dhe ende nuk jemi kompenzuar, edhe pse kanë shkuar në Prishtinë dhe janë premtuar që do të kompenzohen pasi që nuk janë shumë. Dhe kërkoj nëse mundeni të ju përgjigjeni në ndonjë mënyrë këtyre qytetarëve.

Naim Behlulaj - dy pyetje për drejtoreshën e administratës, në radhë të parë a ka informacion që dy javë në zyrën e vendit në Rakosh nuk ka rrjet dhe qytetarët janë të obliguar të vijnë në Istog të nxjerrin dokumentet. Dy a ka informacion që Policia e Kosovës është vendosur e ka marrë një zyrë aty edhe e ka pastruar dhe e ka vendosur flamurin, kjo është në kundërshtim me kërkesat e qytetarëve, qytetarët kërkojnë që Policia të jenë në zyrën ku kanë qenë me herët e jo në atë zyrë. Për drejtoreshën e para është më shqetësuese, kjo përsëritet shpesh.

Ajshe Metaj - pyete drejtorin e arsimit, në kolektivin tonë dy punëtorë kanë filluar punën më 15 nëntor dhe që nga ajo datë e deri me tani nuk kanë marrë pagë asnjëra, ato më pyesin se çka po ndodhë. Ndoshta mund të përgjigjesh tani drejtor apo një ditë tjetër. Edhe një punëtorë që ka qenë në Biologji Edonisa Hasanaj, faktikisht ajo e ka zëvendësi Gëzime Pacaj punëtoreshë nga 1 shkurti dhe kur erdhën listat e pagave ajo nuk e ka emrin aty, dhe me porosi çka po ndodhë. A ka mundësi kur bëhet zëvendësimi kur dihet se ka me dalë në pension profesori i biologjisë më u shpall konkursi përpara.

Labinot Alijaj - vërejtje, sa i përket dëgjuesve po ka mungesë të tyre a është mungesë në kuvend apo çfarë është në pyetje se bashkë pata dëshirë me ditë se çka tha kolegu kur e përmendi Isa Mustafën me jete zhigë.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete drejtorin e shërbimeve publike pse ende nuk ja kanë filluar punimet e varrezave në fshatin Lubozhdë.

Edona Bujupi Loxha, përshëndet të gjithë të pranishmit, Naim sa i përket njoftimit në jemi të njoftuar dhe kemi bërë kërkesën ky problem është pothuajse që dy javë për shkak të mungesës së rrjetit VPN e kemi bërë kërkesën në agjencionin shoqërisë së informacionit mirë po problemi është me antenë, se ata kanë pas kontratë me një kompani, me një operator ekonomik ndërsa pas përfundimit të kontratës ata e kanë

bere edhe shkyçjen e rrjetit tash tata janë duke e tenderuar dhe kanë për me rregulluar. Nuk besoj që qytetaret kanë mbetur pa i krye të gjitha obligimet e tyre, jomë takuar edhe më ta, edhe tjetra është që shumë shpejt do ta kemi edhe E-kioskën aty edhe këto mund të kryhen aty por prape së prape nëse nuk ka rrjet VPN aty atëherë kjo është e kotë.

Sa i përket vendosjes së policisë e di që janë vendosur aty, dhe me sa e di është përshëndetur nga qytetaret e Komunës së Istogut dhe përkatësisht nga qytetaret e fshatit Rakosh, ky është Vendim i Kryetarit të Komunës. Nuk besoj që paraqet problem pasi që zyra ka qenë e zbrazet deri më tani dhe qytetaret mund të ndihen më të sigurt aty.

Kryetari i Komunës - atë vendim e kam marr unë, edhe për Banjë edhe për Gurrakoc në Gurrakoc e kam lëshuar zyrën e LDK-së. Është në shërbim të qytetareve së për siguri është e mirë prezenca e Policisë. E stacion te ri Policor nuk është Ideja më bë aty. Policia donë të jetë lëvizëse, që dalin në teren dhe ta kenë një pikë ku mund të ulen dhe të bisedojnë më qytetarin.

Naim Behlulaj - tek ne është interpretuar ndryshe Kryetar, që do të jetë zyre si në Istog. Kjo është e mirë.

Enver Rugova - ky është problem shumë kompleks varrezat e Lubozhdës, por unë Ardita të inkurajoj edhe ty edhe komunitetit aty ku jetoni se ne si drejtori për shërbime publike bashkë më drejtorin e gjeodezisë dhe kadasrit e kemi zgjedh lokacionin ku na u është rekomanduar këtu është një problem brenda komuniteti të fshatit Lubozhdë ku të Kryetari vjen një delegacion të unë vine dy më kërkesa të kundërta, njëra palë kërkon që varrezat të jenë te rruga e bjeshkës atje në anën lindore ndërsa tjetra me ton që të jenë në Pollaqer një vendim i Kuvendit i legjislaturës së 4 është që është nda lokacioni për varreza të Pollaqeri mirë po aty duhen mjete të mëdha me pastruar vendin nga mbeturinat më shumë së 200 mijë euro ka nga 1 m deri në dy metra nga gjuajtja e mbetjeve inerte.

Kryesuesi – faleminderit për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 14:30.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**



**Kryesuesi i Kuvendit,
Z. Gaus Balaj**

